



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060-01-1601-26

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg

Data / Datum / Date 16. 01. 2026

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.25.11.2025, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Bajram Hashani, Labinot Mirena, Sami Ahmeti, Albana Shillova Shalaku dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: përf.e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve Obiliq (2026 – 2029)
4. Shqyrtimi i kërkesave
5. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve Obiliq (2026 – 2029).

Enver Gashi – Ne si grup jemi që kjo pikë e e rendit të ditës të shkoj për shqyrtim në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Në fakt ky Plan veç ka kaluar debatin publik me sa e di unë dhe ne jemi dakord që kjo të shkoj në seancën e radhës dhe aty do ta japim kontributin tonë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve Obiliq (2026 – 2029).

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për shfuqizimin e vendimit nr.01-104-02-29663-25, të dt.29.09.2025 për realizimin e shujtave ditore për nëpunësit e Shërbimit Civil të Administratës të Komunës së Obiliqit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shfuqizimin e vendimit nr.01-104-02-29663-25, të dt.29.09.2025 për realizimin e shujtave ditore për nëpunësit e Shërbimit Civil të Administratës të Komunës së Obiliqit.

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për shfuqizimin e vendimit nr.01-060-01-33374-25, të dt. 24.10.2025 për ndarjen e mjeteve financiare për pagesën e shujtave për punëtorët shëndetësor të Komunës së Obiliqit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shfuqizimin e vendimit nr. e vendimit nr.01-060-01-33374-25, të dt. 24.10.2025 për ndarjen e mjeteve financiare për pagesën e shujtave për punëtorët shëndetësor të Komunës së Obiliqit.

Kryesuesja - Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës – SBASHK për pagesat e shujtave për anëtarët e SBASHK-ut, në sektorin e Arsimit në Obiliq dhe propozoi që kjo kërkesë të refuzohet sepse është po e njejta dhe nuk ka asnjë arsye të dërgohet në Kuvend se mundet Komuna me i paraparë mjetet në vijën buxhetore pastaj, mund të aprovohet.

Sami Ahmeti – Po, saktësisht atë deshta ta them pa marrë parasysh qysh kanë shkue këto dyjat paraprakisht sepse në parim afërsisht veç e kemi ditë se do të jetë një rezultat i tillë. Edhe unë jam dakord që kjo kërkesë të mos shkoj fare në seancë sepse kështu dhe ashtu përfundon njëjtë sikur kjo, kështu që sido që doni ju të paktën le të kalohet në mandatin e ardhshëm, në mënyrë që mos të marrim vendime të paligjshme.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për dhe 1 votë abstenim e refuzuan shqyrtimin e kërkesës nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës – SBASHK për pagesat e shujtave për anëtarët e SBASHK-ut, në sektorin e Arsimit në Obiliq.

Pika 5 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – Unë vetëm deshta me falenderue këtë ekipë që kemi qenë për 4 vite bashkë dhe shpresoj që edhe në të ardhmen të kemi një bashkëpunim të mirë. Nëse, ndonjëherë e kemi ofendue ndonjërin që kemi provue mos me bë atë unë kërkoj falje dhe shpresoj që në të ardhmen ta kemi një bashkëpunim sa më të mirë.

Kryesuesja - Të nderuar, anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa meqë, është mbledhja e fundit në këtë përbërje ju falenderoj shumë për 4 vite bashkëpunim dhe mirë u takofshim në mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Mbledhja përfundoi në ora 11:19 ’

Zyrtare e Lartë për punë të KK


Azize Zeneli

